



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-006

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokati Nebojsa Vlajic, nga Mitrovica, për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë A.Sh. – R., dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit, V.T., me 02.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga avokati Nebojsa Vlajic, ndaj kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë A.Sh.-R. dhe kryetarit të Gjykatës së Apelit V.T..

A r s y e t i m

Mbrojtësi i autorizuar i te dënuarit I.T., avokat Nebojsa Vlajic, nga Mitrovica, ka paraqitur ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me 31 mars 2023, konform nenit 9 par.2 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, e ka përcjellë ankesën tek kryetari i Gjykatës së Apelit si autoritet kompetent për të vendosur lidhur me ankesën. Meqë me ankesë mbrojtësi shpreh pakënaqësi edhe në punën e kryetarit të Gjykatës së Apelit, ky i fundit me 4 prill 2023, ankesën e lartcekur e ka përcjell tek Gjykata Supreme si autoritet kompetent sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të kryetares të Gjykatave Themelore dhe kryetarit të Gjykatës së Apelit (neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Parashtruesi i ankesës pretendon se klienti i tij, Ivan Todosijevic, nga Zveqani, me 23.03.2023 kishte pranuar urdhrin për t'u paraqitur në vuajtje të dënimit në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, të cilin urdhër ia kishte dërguar kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për të mbajtur dënimin me burgim, të shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me numër të lëndës PS.nr.59/2021. Sipas urdhrin, aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, por këtë të fundit nuk e kanë pranuar as ai, si mbrojtës, e as klienti i tij. I mbrojturi i tij nuk i është shmangur pranimin të ndonjë shkresë, kurse sjellja e gjykatës e cila kërkon që i pandehuri të paraqitet në vuajtje të dënimit sipas aktgjykimit të cilin nuk e ka parë kurrë është skandaloze dhe formë e presionit ndaj të pandehurit. Për ekzistimin e aktgjykimit të shkallës së dytë kanë kuptuar me shumë se tri javë me parë dhe atë vetëm përmes teksteve në gjuhën shqipe dhe në portale të internetit dhe nuk dyshojnë në ekzistimin e aktgjykimit, mirëpo nuk iu është dorëzuar. Përgjegjës për këtë mund të jetë dikush nga Gjykata e Apelit deri në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nga anëtarët e kolegjit, punëtorët e shkrimores, daktilografët që kanë shtypur aktgjykimin, përkthyesit duke përfshirë edhe kryetarët e të dy gjykatave.

Edhe pse ankesa nuk përmban elementet e përcaktuara sipas nenit 9 par.4 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si autoritet kompetent e kam trajtuar sipas detyrës zyrtare duke pas parasysh se përmban informata bindëse se shkeljet e supozuara mund të jenë kryer. Me qëllim të vërtetimit të bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj, të këtyre pretendimeve në drejtim të shkeljeve të supozuara nga kryetarët e gjykatave, kam kërkuar nga të njëjtit që të deklarohen dhe kam pranuar deklaratat e tyre.

Kryetari i Gjykatës së Apelit në deklaratën e tij thekson se aktvendimet dhe aktgjykimet të cilat plotësojnë kushtet për publikim dhe pasi të anonimizohen publikohen në ueb-faqe të gjykatës konform udhëzimit të administrativ nr.04/2019, për publikim të aktgjykimeve të përpunuara si dhe udhëzimin administrativ nr.01/2021, për plotësimin dhe ndryshimin e aktgjykimeve të përpunuara. Kurse, sa i përket çështjes se a e ka marrë pala në fjalë aktgjykimin apo jo, kjo çështje është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë.

Kurse, Kryetarja e Gjykatës Themelore në deklaratën e saj thekson se e ka dërguar urdhrin, aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, me numër të lëndës APS.nr.2/2023, kurse sipas mbrojtësit, aktgjykimin e shkallës së dytë nuk e kanë pranuar asnjëherë, as i dënuari e as mbrojtësi i tij, askush nuk e ka dorëzuar aktgjykimin e as që kanë bërë përpjekje që ta dorëzojnë.

Në deklaratën e saj, kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë thekson se me 01.03.2023, në atë Gjykatë janë pranuar, shkresat e lëndës PS.nr.59/2021, së bashku me kopjet e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, APS.nr.2/2023 datë 28.02.2023, me të cilin aktgjykim është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin i pandehuri Ivan Todosijevic është shpall fajtor për veprën penale Nxitje e urrejtjes, përçarjes dhe mos durimit kombëtar, fetar, racor apo etnik nga neni 147 par. 1 të KPRK-së dhe dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Të njëjtën ditë aktgjykimit PS.nr.59/2021, i është dhënë vula e plotfuqishmërisë, dhe janë ekspeduar vendimet APS.nr.2/2023, nga Zyra e Shkrimores së

Departamentit Special, dhe po nga kjo zyrë është dërguar lënda për ekzekutim në zyrën e ekzekutimeve të kësaj gjykate. Me 9.03.2023 ka lëshuar urdhëresë për të pandehurin që me datë 03.04.2023 të paraqitet në qendrën e shërbimit korrektues në Mitrovicë për ta vuajtur dënimin, të cilën urdhëresë i pandehuri e ka pranuar me 23.03.2023. Kurse, me 27.03.2023 ka pranuar ankesën e ushtruar nga avokati i të pandehurit në të cilën ka shpreh shqetësim se i mbrojturi i tij ka pranuar urdhëresën për paraqitjen në vuajtje të dënimit, por nuk e ka pranuar aktgjykimin e shkallës së dytë, dhe pse u është dhënë aktgjykimi gazetarëve dhe shtypit pa e marrë aktgjykimin i mbrojturi i tij. Pasi që ka marrë ankesën e mbrojtësit ka ndërmarrë veprime për të marrë informacione në lidhje me pretendimet e mbrojtësit dhe nga zyra e shkrimores së Departamentit Special është njoftuar se Gjykata e Apelit fillimisht lëndën e ka dërguar në gjuhën shqipe dhe pas disa ditëve e ka dërguar aktgjykimin në gjuhën serbe. Aktgjykimin në gjuhën serbe mbrojtësi dhe klienti i tij e kanë marrë me 28.03.2023. Publikimin e aktgjykimit në media e ka bërë Gjykata e Apelit. Kurse, me 31.03.2023 nga mbrojtësi i të pandehurit e ka pranuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të dënimit me burgim, të cilën kërkesë me aktvendimin ED.nr.225/2023 datë 07.04.2023, e ka aprovuar duke e shtyrë ekzekutimin për dy muaj, në të cilin aktvendim i është dhënë përgjigje edhe për arsyet e ndërmarra nga gjykata në lidhje me urdhëresën e lëshuar dhe i është dhënë përgjigje për pretendimet e tij që lidhen me ekspedimin e vendimit nga gjykata.

Në bazë të lartcekurave, konsideron se i ka ndërmarrë të gjitha veprimet konform përgjegjësi që ka për ekzekutimin e dënimit, kurse, dërgimi i aktgjykimit në gjuhën serbe dhe dorëzimi i aktgjykimit në gjuhën e të pandehurit dhe publikimi i aktgjykimit është bërë nga Gjykata e Apelit, prandaj konsideron se nuk ka bazë për inicim të procedurës disiplinore. Deklaratës ia ka bashkëngjitur këto prova: urdhëresën për ekzekutimin e dënimit me burg datë 1.03.2023, urdhëresën për paraqitjen në institucionin për mbajtje të dënimit ED.nr.225/2023 datë 9.03.2023, ankesën e mbrojtësit të pandehurit datë 23.03.2023, njoftimin e publikuar në ueb-faqe të Gjykatës së Apelit, vendimin e gjykatës ED.nr.225/2023 datë 7.04.2023 me të cilin i është aprovuar kërkesa e të dënuarit për shtyrjen e fillimit të vuajtje së dënimit me burgim.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratave të kryetarëve dhe provave të cilat ia kanë bashkëngjitur deklaratave, vlerësoj se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur rast disiplinor ndaj tyre, për këto arsye:

Së pari, me ankesë nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryera nga kryetarët e gjykatave. Përkundër kësaj si autoritet kompetent për vlerësimin e ankesave sa i përket pretendimeve për shkeljet e supozuara disiplinore nga kryetarët e gjykatave përkatëse, e kam trajtuar ankesën sipas detyrës zyrtare, meqë përmbante informata se mund të jenë kryer shkelje nga ana e tyre.

Se dyti, sipas provave të cilat i janë bashkëngjitur deklaratave, del se gjykata e shkallës së dytë në çështjen penale të klientit të ankuesit ka vendosur me 20.02.2023, dhe pasi që është përpiluar aktgjykimi me shkrim në gjuhën shqipe, ajo gjykatë me 28.02.2023 ka lëshuar komunikatë për media përkitazi me mënyrën e vendosjes (refuzimin e ankesave) në këtë çështje dhe arsyetimin në pika të shkurta të aktgjykimit të kolegjit të gjykatës, por nuk e ka publikuar aktgjykimin e

përpiluar në ueb-faqe të Gjykatës dhe nuk ua ka dërguar mediave aktgjykimin e përpiluar me shkrim, ngase atyre nuk ju dërgohet aktgjykimi. Në fakt, mediat kanë cituar komunikatën e Gjykatës së Apelit.

Ndërsa, është evidente se lënda është dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë me 1.03.2023 vetëm në gjuhën shqipe dhe me vonë është dërguar aktgjykimi i përkthyer në gjuhën serbe, kurse të mbrojturit të ankuesit pasi që i është dorëzuar aktgjykimi në gjuhën shqipe më vonë i është dorëzuar në gjuhën e tij (gjuhën serbe) me 28.03.2023, për çka me 29.03.2023 ankuesi (mbrojtësi) parashtron kërkesë për shtyrje të fillimit të vuajtjes së dënimit të mbrojturit të tij (e cila i aprovohet), por këto veprime janë pasojë e lëshimeve të administratës së Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore (për të cilat, kryetarët e këtyre gjykatave nuk kanë pasur njohuri) dhe nuk mund t'u atribuohen kryetarëve të gjykatave përkatëse.

Nga arsyet e cekura e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës së Apelit,
3. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë,
4. Palës ankuese,
5. Arkivit të Gjykatës Supreme.